REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 11/23
Datë/Datum. 16. 01. 2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Remzi Llumnica *Ekspert. Shqyrtues - nënshkrimi*	*10.01.2023*	*16.01.2023*	Nr. i lëndës: *11/23*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **04.01.2023, OE N.T.P."Bletaria Egzoni" me seli ne Gjakove-**, ka parashtruar ankesë me numër **2023/0000019** kundër procedurave të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim me shoqëri bletësh dhe koshere**" me nr. të prokurimit: **615-22-13928-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E PODUJEVËS .**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë : **Procedurë e hapur**: **Furnizim**, vlera e parashikuar e kontratës: **65,000.00** €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

TE DHENAT MBI AKTIVITETIN E PROKURIMIT

• **Njoftimi për kontrate**	**05.12.2022**
• **Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje**	**27.12.2022**
• **Kriteri për tenderin -**	**Çmimi më i ulët**
• **Aktiviteti i prokurimit, i përsëritur**	**4 herë**
• **Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues**	**Anulim**
• **Kërkese për Rishqyrtim**	**20.12.2022**
• **Përgjigje nga AK sa i përket ankesës se OE**	**22.12.2022**
• **Ankesa drejtuar OSHP-së**	**04.01.2023**

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

- Shkeljet e dispozitave te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar
- dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092:
- Neni 1 i LPP Nr. 04/L-042 - Qëllimi;
- Neni 7 i LPP Nr. 04/L-042 - Barazia në Trajtim/Jo-diskriminimi;
- Neni 16 i LPP Nr. 04/L-042 - Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim;
- Neni 27 i LPP Nr. 04/L-042 - Dosja e Tenderit;
- Neni 13 - Rregullore Nr.001_2022 për Prokurimin Publik -Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës;
- Neni 17.7 - Rregullore Nr.001_2022 për Prokurimin Publik - Dosja e Tenderit.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, nuk janë të njëjta.
Pretendimet ankimore te OE ankues.
Pretendimet ankimore
OPERATORI EKONOMIK - " N.T.P."Bletaria Egzoni" me seli ne Gjakove.

Të pakënaqur në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 22.12.2022 ne lidhje me projektin **"Furnizim me shoqëri bletësh dhe koshere"**, me nr. te prokurimit **615-22-13928-1-2-1** ku OE dyshon se Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se pasi qe konform pikës 2 te nenit 108/A është pezulluar aktiviteti i prokurimit bazuar në kërkesën për rishqyrtim nga **OE "N.T.P."Bletaria Egzoni" me seli ne Gjakove.**

Te nderuar, ju njoftojmë se është hera e katërt (4) qe ne si operator ekonomik jemi duke tenderuar ne ketë aktivitet te prokurimit, qe nga data 29.11.2018, dhe i kemi plotësuar te gjitha kushtet e parapara të dosjes dhe specifikimet teknike, ku është dashur edhe të shpallemi si OE i rekomanduar për kontratë.
Fillimisht ju rikujtojmë se ne ketë aktivitet i prokurimit jemi shpallur fitues i këtij tenderi me date 16.08.2021, por pasi që lënda është dërguar në OSHP. AK-ja ka kthyer lëndën në rivlerësim pa një vendim nga ana e OSHP-së, ku pas rivlerësimit ka rekomanduar për kontrate OE "Hidro Project ShPK qe kur analizohet oferta e te njëjtit shihet qartë se ky OE nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit dhe specifikimet teknike te përcaktuara në dosje të tenderit.

Te nderuar AK-ja me dt. 05.12.2022 ka publikuar tenderin me titull "Furnizim me shoqeri bletesh dhe koshere".

Fillimisht ju sqarojme se ky akitivitet i prokurimit po ri tenderohet per here te katert tani, ndersa ne tri heret e kaluara eshte anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se OE ofertues kane tejkaluar vleren e parashikuar dhe se çmimi ofertues eshte i paperballueshem per autoritetin kontraktues.

Pra edhe pse ky aktivitet i prokurimit eshte anuluar tri here radhazi per shkak te vleres se vogel te cilen AK-ja e ka parashikuar dhe per kete fakt OE kane ofertuar me çmim me te larte, e njejta perseri vleren e parashikuar te ketij aktiviteti te prokurimi e ka percaktuar ne shumen 65,000.00€ ne total dhe gjithashtu edhe sasine e koshereve dhe bleteve e ka percaktuar ne numer te njejte sikurse ne heret e kaluara.

Pretendimi nr. 1
Duke e marr parasysh faktin se ky aktivitet i prokurimit eshte anuluar tri here radhazi, atehere autoriteti kontraktues eshte dashur qe vleren e parashikuar ta rrit duke i pasur parasysh cmimet e produkteve (koshereve dhe bleteve) dhe jo te veproj perseri njejte duke mos i pasur parasysh rrethanat qe ky aktivitet i prokurimit perseri mund te anulohet per shkak te parashikimit te ulet te vleres se parashikuar ne krahasim me cmimet e furnizimeve qe do te behen.

AK-ja me rastin e parashikimit te vleres se ketij aktiviteti te prokurimit, nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 16 te LPP-se ku percaktohet qarte se "1. Vlera e parashikuar e kontrates se propozuar per furnizim duhet te jete e barabarte me qmimin perfundimtar qe duhet te paguhet nga autoriteti kontraktues per te gjitha produktet, sherbimet dhe objektet e tjera qe perfshihen ne nje kontrate te tille. Çmimi i parashikuar i produkteve, sherbimeve dhe objekteve eshte çmimi i parashikuar i tyre ne diten e dergimit te njoftimit te kontrates lidhur me to. Gjate percaktimit te vleres se parashikuar te nje kontrate te propozuar per furnizim, autoriteti kontraktues do t 'i perfshije te gjitha elementet e çmimit perfundimtar qe mund te parashikohen ne menyre te arsyeshme, qe do ti paguhet nga autoriteti kontraktues per produktet, sherbimet dhe lendet e tilla, duke perfshire çfaredo dhe te gjitha taksat, doganat dhe tarifat e tjera".

Pretendimi nr. 2
Keshtu siç AK-ja e ka planifikuar vleren e parashikuar per kete aktivitet te prokurimit, e njejta po bie ndesh me dispoziten e lartcekur, pasi qe ka parashikuar nje vlere me te ulet se sa duhet per sasine e kerkuar te koshereve.

Sa per sqarim ne kemi marr disa oferta nga nje kompani per te ju sqaruar me fakte se vlera e parashikuar me sasite e

kerkuara ne kete aktivitet te prokurimit nuk jane ne proporcion me njera tjetren, sepse vlera per sasite e kerkuara e tejkalon shumen prej 65,000.00€, te parashikuar nga AK- Ja.

Nga pro faturat qe po i bashkangjesim shjhen qarte çmimet si ne vijim:

Pro fatura e cila eshte leshuar si oferte nga kompania Golden Bee SH.P.K., shihet qarte se cmimi per nje koshere me blete 6 korniza eshte 140.00€, ndersa per nje koshere antivaro çmimi na eshte ofruar ne vlere 70.00€. Kur analizohet sasia e kerkuar nga AK-ja me cmimet e dhena ne pro faturen e lartcekur, i bie qe qmimi per pozicionin ,Furnizim me shoqeri bletesh se bashku me koshere " eshte 700x140=98,000.00€, ndersa per pozicionin Furnizim me shtepiza tre kateshe antivaro", eshte 140x70=9,800.00€, ku totali i bie 107,800.00€.
Gjithasbtu ne kemi marr edhe nje oferte tjeter nga N.T.P. BLETMIRI, ku çmimi per nje koshere nje kateshe antivaroa me 6 korniza na eshte dhene cmimi 135.00€, ndersa per nje koshere tre kateshe antivaroa na eshte ofruar cmimi 69.00€. Ku nese mblidhet totali i kesaj oferte eshte ne vlere l 04,160.00€.

Nga dy ofertat e lartcekura kuptohet qarte fakti se ky aktivitet i prokurimit nuk mund te perfundohet me vleren qe ka parashikuar AK-ja per kete aktivitet te prokurimit, pasi qe asnje kompani nuk mund te perfundoje kontaraten me vleren e parashikuar qe ka dhene e njejta ne dosje te tenderit.
Per te vertetuar edbe me shume kete fakt, ne po ju bashkangjesim edhe dy oferta tjera nga dy kompanj te tjera, ku edhe nga keto dy oferta vertetohet fakti se vlera e parashikuar per kete aktivitet eshte shume e vogel ne krahasim me sasine e kerkuar.

Pretendimi nr. 3
Duke u bazuar ne faktet e lartcekura kerkojme nga ju qe te detyroni AK qe te rrit vleren e parashikuar ne minimum 100,000.00€. ose ne rast qe nuk ka buxhet te bejn rritjen e vleres se parashikuar atehere kerkojme qe te detyroni autoritetin kontraktues qe te zvogeloj sasite e kerkuara duke e analizuar cmimin e tregut per nje produkt dhe te analizon sakte se cfare sasie duhet te kerkohet per vleren 65,000.00€.

Ne me dt.23.12.2022 kemi pranuar vendimin e AK-se ne lidhje me kerkesen tone per rishqyrtim, ku e njejta nuk ka dhene pergjigje se a eshte aprovuar kerkesa jone per rishqyrtim apo eshte refuzuar.

E njjta ne vendimin per kerkesen per rishqyrtim ka dhene arsyetimin si ne vijim:

> Parashtrimeve i kërkesës për rishqyrtim ka paraqitur pretendimet ankimore ndaj vlerës së parashikuar të buxhetit për këtë projekt.
> Pas shqyrtimit të kërkesës së juaj, Autoriteti Kontraktues menjëhere i njoftoi dhe kontaktoi me drejtorin e bujqësisë si njësi kërkuese dhe drejtorin për buxhet dhe financa muarren vendim se shtim te buxhetit në këtë fundvit nuk ka mundësi buxhetore e as mundësi të ndrrimit të disponushmeris së mjeteve dhe ne vetimin tjetër shtesë deri në fillim të buxhetit të ardhshëm.
>
> Andaj të ndërtuar përmbajtu përgjigjeve tona ndaj sqarimeve shtesë të kërkuara nga ana juaj e të dërguara dhë me pure nga AK-ja të marrura nga njësitë kërkuese.

Gjithashtu ka bashkangjitur edhe nje komunikim me njesine kerkuese:

> Sikkesa e dërguar nga njësia kërkuese:
>
> Majlinda.B. Gashi
> Sent: [illegible]
> To:
> prokurimi podujeva
> Cc:
> Çamir Bozlari
>
> Të nderuar,
>
> Shpresojme te jeni mire me shendet dhe pune. Ju njoftojme se njesia kerkuese me perpikmeri e ka lexuar kerkesen per rishqyrtim ne lidhje me projektin "Furnizim me shoqeri bletesh dhe koshere", andaj ju lutemi referojuni sqarimit shtese te derguar permes email-it te kafuar ne lidhje me projektin ne fjale.
>
> - Ndërsa nga Drejtoria per Buxhet e Financa: Sa i perket mundësive tona buxhetore, një ngritje lejuar sipas LPP-së, mbrenda kufive të lejuar mbi vlerën e parashikuar për këtë projekt mundësisht do të bëjme përpjekje që ta shiqyrtojm në fillim të buxhetit të viti të ardhshëm.

Nga pergjigja e lartcekur kuptohet se pretendimet tona ankimore nuk jane marr parasysh, pasi qe e njejta e ka cekur se ne duhet te i permbahemi pergjigjeve te AK-se te dhena ndaj sqarimeve shtese te cilat i kemi here me heret ne lidhje me vleren e parashikuar.

Pretendimi nr. 4

Ne, ne kerkese per rishqyrtim kishim parashtruar pretendimet se duhet te ndryshohet/rritet vlera e parashikuar, mirepo ne rast se nuk ka mundesi te rritjes se vleres se parashikuar atehere kemi kerkuar qe te zvogelohen sasite e kerkuara te koshereve. Edhe perkunder ketyre pretendimeve tona, AK-ja me qellim te devijimit nga pretendimet tona ankimore, e njejta eshte fokusuar vetem tek rritja e vlerës se parashikuar duke mos i dhene fare rendesi pretendimit tone ankimor sa i perket zvogelimit te sasive te kerkuara ne koshereve.

Nga ky veprim i AK-se edhe nje here po shihet tendenca e saj qe te vazhdoj me kete aktivitet te prokurimit, pa e ndryshuar fare vleren e parashikuar, mirepo edhe pa i zvogeluar fare sasite e kerkuara nga e njejta.

Gjithashtu ne rast se AK-ja ka qene e interesuar qe te bej rritjen e vleres se parashikuar ne fillim te vitit, atehere eshte dashur te specifikoj qarte nje gje te tille, duke na aprovuar kerkesen per rishqyrtim dhe te konstatoj se pretendimet tona ankimore jane te bazuara. Mirepo perderisa e njejta nuk ka bere nje veprim te tille atehere ne jemi te detyruar te parashtrojme ankese ne OSHP, me qellim te shmangies se mundesise per anulimin e katert me radhe te ketij aktiviteti te prokurimit dhe diskriminimit te OE ofertues.

Duke u bazuar ne te gjitha deshmite dhe kundershtimet tona qe u ceken me larte rezulton se AK-ja nuk e ka perpiluar dosjen e tenderit ne harmoni me neni_n 27 te LPP-se dhe njekohesisht nuk e ka pasur parasysh as nenin 17.7 te Rregullores nr.001/2022 per Prokurim Publik ku shkruan qarte qe Dosja e tenderit do te pergatitet ne menyre qe nuk:

a. Kufizon konkurrencen ne mesin e OE. ose
b. Diskriminon kunder ose vepron ne favor te nje ose me shume OE".

Me vleren e parashikuar per kete aktivitet te prokurimit AK-ja nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 13 te Rregullores nr.001/2022 per Prokurim Publik, ku ceket qarte "13.1 Vlera e parashikuar e nje kontrate publike duhet te parallogaritet para inicimit te procedures se prokurimit. Parallogaritja e tille duhet te jete e arsyeshme dhe reale per kontraten e parashikuar.13.3 Ne parashikimin vleres se kontrates AK eshte pergjegjes per krahasimin e cmimeve te tregut, cmimeve te kontratave paraprake kur ato ekzistojne, etj, me analize te kostos te specifikimeve relevante teknike te mallrave, sherbimeve ose puneve per prokurim. ".

Duke u bazuar ne te gjitha faktet e lartecekura dhe me vleren qe e ka parashikuar AK-ja, rezulton se ne kete menyre nuk mund te arrihet qellimi i LPP-se, sic parashihet ne nenin 1 te ketij ligji, e ku shkruan qarte: Qellimi i ketij ligji eshte te siguroj menyren me efikase, me transparenle dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove.

Duke pasur parasysh te gjitha arsyet ligjore qe u permenden me larte, kerkojme nga OSHP-ja qe te merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE N.T.P "Bletaria Egzoni"
NDRYSHOHEN kerkesat, qe u ceken me larte dhe pastaj te veprohet konform nenit 53.7 te LPP- se.
Nese nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojme proceduren ligjore ne institucionet tjera kompetente.

Dëmet materiale

Neve si Operator Ekonomik na jane bere dëme materiale per përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës , ne vlere prej 5,000.00 euro..

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, nuk janë të njëjta. Pretendimet ankimore të AK .

AUTORITETI KONTRAKTUES – Komuna e Podujeves, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim nga "OE OE N.T.P."Bletaria Egzoni" me seli ne Gjakove, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me shoqëri bletësh dhe koshere" me nr. të prokurimit: 615-22-13928-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS mori këtë:

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Departamenti i Prokurimit

Podujevë: datë,22.12.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Podujevës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 2) të Ligjit për Prokurimit Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 6 (paragrafi 6.1) të Rregullave për Parashtrim te Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave të datës 20.12.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " NTP Bletaria Egzoni, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me shoqëri bletësh dhe koshere "**, me Nr. të Prok: 615-22-13928-121– nr. i brendshëm 61522011 121 – nxjerr:

VENDIM
MBI PEZULLIMIN E AKTIVITETIT TE PROKURIMIT

I. Pezullohet aktivitetin e prokurimit me titull:**"Furnizim me shoqëri bletësh dhe koshere"**, me Nr. 615-22-13928-121 Nr. Brendshëm 61522 011-121

II. Për hapat tjerë lidhur me këtë aktivitet te porkurimit,me kohë do të jeni të informuar përmes platëformes së prokurmit elektronik.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe do të publikohet për të gjitha palët e interesuara në platformën elekronike ne adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

Rasim Fejza
Menaxheri i Prokurimit

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës se Parashtruar për Ri-Shqyrtim të dt. 20.12.2022 nga Operatori Ekonomik NTP"**Bletaria Egzoni**", lidhur me Aktivitetin e Prokurimit "**Furnizimi me shoqëri bletësh dhe koshere**" me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-22-13928-1-2-1, njëjtë këtë:

VENDIM

I. Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik NTP"**Bletaria Egzoni**", me datë 20.12.2022, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit "**Furnizimi me shoqëri bletësh dhe koshere**" me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-22-13928-1-2-1, kundër Njoftimit për kontratë të publikuar me 05.12.2022 te publikuar ne ueb-faqe te KRPP-ës.

II. AK- Shqyrtoi kërkesën për rishqyrtim për pretendimet ankimore ndaj vlerës së parashikuar të buxhetit për këtë projekt të planifikuara nga njësia kërkuese dhe pas konsultimeve me njësin kërkuese dhe drejtorin për buxhet e financa, vendosi sipas përgjigjeve të AK-së, ndaj sqarimeve shtesë të kërkuara nga ana juaj, por me mundësi rishikimit mbrenda kufive të lejuar mbi vlerën e parashikuar për këtë projekt mundësisht do të bëjmë përpjekje që ta shiqyrtojm në fillim të buxhetit të vitit të ardhshëm.

III. AK-Pezulloi në Apel, aktivitetin e prokurimit me dt.22.12.2022, ndërsa për datën e dorzimit të ofertave do të njoftoheni me kë në platformën e prokurimit.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike te e-prokurimit ne ueb-faqen: https://e-prokurimi.rks-gov.net

Arsyetimi

Operatori Ekonomik NTP"**Bletaria Egzoni**", me date 20.12.2022, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me Aktivitetin e Prokurimit "**Furnizimi me shoqëri bletësh dhe koshere**" me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-22-13928-1-2-1, kundër Njoftimit për kontratë të publikuar me 05.12.2022 te publikuar ne ueb-faqe te KRPP-ës.

Parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim ka paraqitur pretendimet ankimore ndaj vlerës së parashikuar të buxhetit për këtë projekt:
Pas shqyrtimit të kërkesës së juaj, Autoriteti Kontraktues menjëhere i njoftoi dhe kontaktoi me drejtorin e buxqëtisë si njësi kërkuese dhe drejtorin për buxhet dhe financa muarren vendim se shtim te buxhetit në këtë fundvit nuk ka mundësi buxhetore e as mundësi të ndrrimit të disponushmeris së mjeteve dhe as zotimin tjetër shtesë deri në fillim të buxhetit të ardhshëm.

Andaj të ndërtuar përmbajtu përgjigjeve tona ndaj sqarimeve shtesë të kërkuara nga ana juaj e të dërguara ditë më parë nga AK-ja të marrura nga njësitë kërkuese.

Shkresa e derguar nga njësia kërkuese:

Majlinda.B. Gashi
Thu 12/22/2022 1:02 PM
To:
prokurimi podujeva;
Cc:
Fatmir Rudaku

Te nderuar,

Shpresojme te jeni mire me shendet dhe pune. Ju njoftojme se njesia kerkuese me perpikmeri e ka texuar kerkesen per rishqyrtim ne lidhje me projektin "Furnizim me shoqeri bletesh dhe koshere", andaj ju lutemi referojuni sqarimit shtese te derguar permes email-it te kaluar ne lidhje me projektin ne fjale.

- Ndërsa nga Drejtoria per Buxhet e Financa; Sa i përket mundësive tona buxhetore, një ngritje lejuar sipas LPP-së, mbrenda kufive të lejuar mbi vlerën e parashikuar për këtë projekt mundësisht do të bëjmë përpjekje që ta shiqyrtojm në fillim të buxhetit të vitit të ardhshëm.

Nga se u eek, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, zyrtari përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato qe u shtan me lart vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në instancat tjera relevante.

Nr. 14-370/01-010481/22
Podujevë, dt.23.12.2022

Menaxheri ZP
Kadrim Fejza

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe Ligjin Nr. 05 L-092 , Neni 65.	Dëshmia 1. Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson Kërkesat për të konkuruar sipas Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04 L-042, Neni 65, duke përdorur formën në Aneksin 2 të Dosjes Tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë qe kërkohen nga tenderuesi qe propozohet qe te shpërblehet me kontrate dhe dorëzohen te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues 2. Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është në vonesë për pagimin e tatimeve, ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga OE të cilit synohet dhënia e kontratës (kopje) 3.Një dokument nga Gjykata Kompetente, që vërteton se operatori ekonomik ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe se ndaj tij nuk ekziston ndonjë rrethanë e përcaktuar me Nenin 65 paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së jo më i vjetër se 6 gjashtë muaj nga data e dorëzimit të tenderit, duhet të dorëzohet nga OE të cilit synohet dhënia e kontratës, të dorëzohet në Origjinal ose kopje e vërtetuar. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentet e kërkuara në pikat, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit ne vendin e dytë e kështu me radh

Përshtatshmëria profesionale	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2. Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit 3. Regjistrimi i numrit fiskal	1. Kopja e certifikatës së biznesit) . 2. Kopja e certificates TVSH-se 3. Kopja e certificates numrit fiscal

Kapaciteti ekonomik dhe financiar	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi bankar i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të shkuara ka qenë prej jo më pak se 125,000.00 euro.	1. Deklaratat vjetore tatimore të ATK-së për qarkullimin e kërkuar në tre vitet e fundit apo konfirmimin nga banka për qarkullimin e kërkuar.

Kapaciteti teknik dhe profesional	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, në vlerë minimale prej 95,000.00 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Në rast të formimit të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së	Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave te nënshkruar dhe te vulosur . Ne listë duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te furnizimeve.

paku 60% të shumës së kërkuar në furnizime të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit	
Ofertuesi duhet të sjell një deklaratë që ka bletishtën e vet dhe që është bletarë dhe që posedon së paku 400 shoqëri bletësh të cilat do të vizitohen nga komisioni vlerësues.	Ofertuesi duhet të sjell një deklaratë që ka bletishtën e vet dhe që është bletarë të nënshkruar dhe vulosur.
Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se bletët janë të regjistruara në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e cila lëshon edhe deklaratën se sa bletë ka të regjistruara bletari e cila dëshmon numrin e shoqërive të bletëve që posedon me numrin NIF.	Të gjitha kosheret e prezantuara nga OE duhet të përmbajnë kodin e regjistrimit të bletarit (OE) përkatësisht NIF-in.
OE duhet të ofroj një deklaratë të analizave laboratorike të AUV kundër sëmundjeve (e paster ndaj sëmundjeve)	Deklarata (dokumenti) nga AUV i cili dëshmon se bletët janë të shëndetshme nga sëmundjet (kërkohet para se të shpallet fituesi)

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "N.T.P."Bletaria Egzoni" me seli ne Gjakove",

Sqarim hyrës - Fillimisht sqarojmë se OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 20.12.2022 me pretendime të njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë. AK me datë 22.12.2022 ka njoftuar OE rreth ankeses se Kërkesa për Rishqyrtim, rrjedhimisht i ka shqyrtuar pretendimet ankimore deri në nivelin e lejuar.
Eksperti Shqyrtues trajton pretendimet që lidhen me veprimet e AK-së në raport me dispozitat e LPP-së, duke mos u lëshuar kështu në trajtimin dhe sqarimin e pretendimeve për shkeljen e dispozitave si dhe rrethanat faktike që supozohet të kenë ndodhur jashtë fushëveprimit të dispozitave të LPP-së.

Pretendimet ankimore te grumbulluara. – Ankese kundër Njoftimit per Kontrate te publikuar me numër te Aktivitetit te Prokurimit 615-22-13928-121 ndaj vlerës se parashikuar te buxhetit per kete projekt te planifikuar nga Njesia Kerkuese.

Përgjigje në pretendimet ankimore –

- OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke marrë vendim për përfundimin e aktivitetit të prokurimit.
  AK me date 20.12.2022 ka pezulluar njoftimin mbi aktivitetin e prokurimit. Në vendimin përshkruhet arsyeja e pezullimit të procedurës së prokurimit publik: "Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit".

- OE ankues pretendon se AK nuk ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim nga vendimi i AK-së për pezullimin e këtij aktiviteti të prokurimit. OE ankues me datë 20.12.2022 ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me pretendimet e njëjta ankimore si në këtë ankesë duke kundërshtuar vendimin për pezulllim. AK, me datë 23.12.2022 ka kthyer përgjigje se Kërkesa për Rishqyrtim nuk ka bazë ligjore në këtë fazë, rrjedhimisht AK nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore por ka dhene vetëm nje alternative mbi hapat te cilët mund te merren nga fillimi i vitit 2023 sa i përket buxhetit . Eksperti Shqyrtues sqaron se ashtu sikurse përcaktohet me nenin 108/A, OE si palë e interesuar që mendon se të drejtat e tij janë shkelur nga vendimi i AK dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues.
- Për me shumë ne njoftimin e AK-së për pezullimin e aktivitetit tek pjesa e ankeses, është dhënë informacioni perveq tjerash se, në bazë të nenit 108/A te ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi eshte bere pezullimi i aktivitetit te prokurimit." Andaj, bazuar në sqarimet e dhëna ne kete vendim te datës 23.12.2023 nder te tjera thuhet se :

> **I.** Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik NTP"**Bletaria Egzoni**", me datë 20.12.2022, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit **"Furnizimi me shoqëri bletësh dhe koshere"** me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-22-13928-1-2-1, kundër Njoftimit për kontratë të publikuar më 05.12.2022 te publikuar ne ueb-faqe te KRPP-ës.
>
> **II. AK-** Shqyrtoi kërkesën për rishqyrtim për pretendimet ankimore ndaj vlerës së parashikuar të buxhetit për këtë projekt të planifikuara nga njësia kërkuese dhe pas konsultimeve me njësin kërkuese dhe drejtorin për buxhet e financa, vendosi sipas përgjigjeve të AK-së, ndaj sqarimeve shtesë të kërkuara nga ana juaj, por me mundësi rishiqimit mbrenda kufive të lejuar mbi vlerën e parashikuar për këtë projekt mundësisht do të bëjmë përpjekje që ta shiqyrtojm në fillim të buxhetit të vitit të ardhshëm.
>
> **III.** AK-Pezulloi në Apel, aktivitetin e prokurimit me dt.22.12.2022, ndërsa për datën e dorzimit të ofertave do të njoftoheni me kë në platformën e prokurimit.

Mbeshtetur ne:

- **Neni 1 Qëllimi 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike** si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.
- **Neni 16 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim** 1. Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me 24 çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë. Çmimi i parashikuar i produkteve, shërbimeve dhe objekteve është çmimi i parashikuar i tyre në ditën e dërgimit të njoftimit të kontratës lidhur me to. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për furnizim, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për produktet, shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, doganat dhe tarifat e tjera.
- **Neni 27 Dosja e Tenderit** 1. Përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet material të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkese të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat 32 ekzekutuese, mundësinë e varianteve dhe informatat lidhur me nën-kontraktimin në pajtim me nenet 28, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji.

- **Rregullore Nr.001_2022 për Prokurimin Publik -Neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës** 13.1 Vlera e parashikuar e një kontratë publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar.13.3 Në parashikimin vlerës së kontratës AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj, me analizë të kostos të specifikimeve relevante teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim.
- **Rregullore Nr.001_2022 për Prokurimin Publik** - Neni 17 Dosja e Tenderi.

Nga ana tjetër:

- ✓ Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimi - 2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;

- ✓ **Rregullore Nr.001_2022 për Prokurimin Publik - Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit 43.7** Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:

a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

- Referuar materialit te sipërpermenduar AK duke mos i shqyrtuar pretendimet ankimore të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar sepse nuk ka pranuar nje përgjigje konkrete nga AK por vetëm nje vlerësim te mundshëm per kete aktivitet te prokurimit.
- Bazuar ne Rregulloren Nr.001_2022 për Prokurimin Publik -Neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës, pika 13.1 dhe 13.3 specifikon qarte se para se te filloje nje aktivitet i prokurimit AK eshte i obliguar qe vlera e parashikuar e një kontratë publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar.13.3 Në parashikimin vlerës së kontratës AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj, me analizë të kostos të specifikimeve relevante teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim.
- Nisur nga shpjegimet e larte cekura AK edhe pse ky aktivitet i prokurimit ka dështuar se funksionuari per te katërtën here prap se prap para publikimit nuk i ka bere kalkulimet e çmimit me vlera reale prandaj edhe ka ardhur te kjo situate ku verat e tregut tejkalojnë vlerën e parashikuar per sasinë e kërkuar ne dosjen e tenderit.
- Nese ka mundësi praktike dhe teorike qe sasia te zvogëlohet dhe te njoftohen te gjithë OE deri ne masën qe te mbulohet me bugjetin e parashikuar atëherë kishte me qene zgjidhje e duhur dhe i njëjti aktivitet i prokurimit te vazhdohet me dorëzim te ofertave.
- Meqenese AK eshte institucion dhe Planifikimi buxhetor ka përfunduar per vitin 2022 ndaj edhe mjetet e ndara tani veq nuk i ka ne dispozicion sepse nuk eshte aktivitet i cili eshte ne procedure pas nënshkrimit te kontratës por eshte ne fazën fillestare dhe AK e ka te pa mundur te vazhdoje po me te njëjtën planifikim.
- Nese paragrafi i lartecekur(vlereseuar nga OSHP) e mundëson qe te vazhdohet me procedure prokurimi duke i zvogëluar sasitë e planifikuara atëherë eshte me mire qe te vazhdohet ky aktivitet, ne te kundërtën duhet te fillohet qe nga fillimi per vitin aktual duke bere planifikimet reale te tregut ne menyre qe mos te rrezikohet projekti per shkak te parashikimit buxhetor dhe specifikimit teknik.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

NBËSHTETUR NË NENET DHE PIKAT E MË SIPERME

EKSPERTI PROPOZONË

Meqenëse janë analizuar të gjitha dokumentet dhe pretendimet ankimore të cilat i shtjelluam me larte, Autoriteti Kontraktues me veprimet/mosveprimet e tyre, NUK ka respektuar ne tersi dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik duke cenuar dhe mos mbrojtur edhe paranë publike duke mos e zbatuar Rregulloren Nr.001_2022 për Prokurimin Publik -Neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës, pika 13.1 dhe 13.3.

Prandaj, rekomandojmë Panelin Shqyrtues i OSHP-se, që sipas detyrës zyrtare dhe kompetencave të saj, të autorizuar sipas ligjit:

- Te aprovojnë si Pjesërisht të bazuar ankesën nga OE N.T.P."Bletaria Egzoni" me seli ne Gjakove
- Te shfuqizojë njoftimin e AK-se, dhe
- Të kthejë lenden ne Rivlerësim ngase gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së nëse nje gje e tille lejohet (gjykuar nga OSHP) pasi qe ky aktivitet i percjellur me procedura te tilla eshte me specifik dhe veshtire per te dhene definim konkret.

Neni 1 – Qëllimi - 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Vërejtje: Ekspertiza është e bazuar në dokumente të cilat eksperti i ka siguruar nga OSHP, AK dhe OE. Meqenëse është një numër i konsiderueshëm i dokumenteve dhe ligjeve që e rregullojnë dhe nxjerrin një mendim të ekspertizës sa më profesionale, nuk përjashtohet mundësia e ndonjë lëshimi , trajtim apo citim i gabuar, i materialit prandaj AK, OE e mbi të gjithë OSHP e ka të drejtën e reagimit duke u mbështetur me fakte nëse diçka e tille nuk është trajtuar në formën më të mirë të mundshme.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Komuna e Podujevës
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - N.T.P."Bletaria Egzoni" me seli ne Gjakove